



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 02/2011
Prishtinë, më 29.03.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani, Biserka Kostić.

Pjesëmarrës të tjerë: Besnik Ramadanaj – KDI, Haxhi Gashi – USAID, Shefki Kastrati – NDI, Lejla Selimi - OSCE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.03.2011;
3. Strategjia Legjislative e Qeverisë për vitin 2011;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17. 03. 2011

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 17.03.2011, u miratua pa vërejtje.

3. Strategjia Legjislative e Qeverisë për vitin 2011

Kryetari – i njoftoi anëtarët e Komisionit se në bazë të Strategjisë legjislative të Qeverisë për vitin 2011 dhe nga Raporti i progresit për vitin 2010, Stafi mbështetës i komisionit ka përgatitur një Projektplan të punës. Andaj ne si Komision parlamentar jemi të detyruar të hartojmë Planin vjetor të punës si program pune për vitin 2011. Theksoi se gjatë hartimit të projekt-programit të punës mund të japin të gjithë anëtarët propozimet e tyre që të futën në planin e punës për vitin 2011.

Teuta Sahatçija – Theksoi se ne nuk jemi të detyruar që t'a përcjellim vetëm Strategjinë e Qeverisë, por ka edhe shumë fusha tjera që mbulon ky komision funksional. Kërkoj që të ketë më shume vizita për monitorimin e ligjeve së sa po zbatohen ato. Në vazhdim theksoi se iniciativat e temave nga Komisioni dhe nga shoqëria civile të jenë në planin e punës për vitin 2011. Propozoi që të formohet një grup punues për planin e punës.

Myzejene Selmani – theksoi që grupi punues gjatë punës mund të dalë me më shumë tema për zhvillimin ekonomik të vendit.

Visar Ymeri - theksoi që nuk është mirë, dhe nuk mund të varet e tërë puna e Komisionit prej punës së Qeverisë. Sepse ne nuk mund ta paragjykojmë tërë punën e Komisionit së çka mund të ndodh. Në vazhdim theksoi që komisioni duhet të jetë më i hapur për shumë çështje të zhvillimit ekonomik, kështu që është një punë dhe fushë e gjerë. Andaj puna e Komisionit duhet të zhvillohet dhe në bazë të rrethanave dhe zhvillimeve në vend.

Ramiz Kelmendi – Theksoi që komisioni në planin e punës për vitin 2011 duhet të kërkoj detyra të reja prej Qeverisë, që t'i përshpejtoj proceset. Dhe shtoi se ne si komision funksional duhet të japim versionet për alternativa të reja.

Lutfi Zharku - theksoi që në Planin e punës po figurojnë disa paqartësi rreth ligjeve, te miratuara lidhur me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, siç është strategjia e rezervave të naftës. Për këtë është miratuar ligji i rezervave shtetërore të mallrave, edhe këtu përfshihen edhe rezervat e naftës.

Kryetari – Sqaroi se janë dy dokumente bazike që e parashikojnë Planin e punës, Strategjia legjislative 2011 dhe sfidat nga Raporti i progresit 2010, më disa pika që duhet të përfshihen në Planin e punës së Komisionit.

Sala Berisha-Shala - theksoi që ne kemi dy dokumente, Strategjinë legjislative të Qeverisë 2011 dhe draftin e Komisionit për Planin punës për vitin 2011, dhe është detyrim dhe detyrë e komisionit që ta kanalizoj punën e vet se cilave çështje më rëndesi dëshirojmë me i shqyrtuar më përpara.

Hashim Deshishku - kërkoi që në grupin punës për Planin e punës për vitin 2011 të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit.

Pas diskutimeve Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

1. *Shtyhet shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2011 për datën 30.03.2011.*
2. *Grupi punues për Planin e punës të jetë i përbërë nga tërë Komisionit.*

4. Të ndryshme

Çështje vijuese

Kryetari – njoftoi anëtarët e Komisionit që mbledhja e radhës mbahet më datë 30.03.2011.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit